



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. Extra Prot.

Tiranë, më 21. 05. 2020

VENDIM

“Mbi zgjidhjen e menjëhershme të kontratës të punës të personelit akademik dhe anëtarë të KIZ të UT Zj.Majlinda Keta, Z.Bernard Dosti, Zj.Oriona Mucollari, Z.Ardian Doka dhe Zj.Eglantina Gishti , nga Rektori i UT dhe veprimtarinë e KIZ aktual të UT”

Bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë neni 57, pika 7; ligjin Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 3, pika 4, gërma a; neni 36, pika 1; neni 37; neni 38, pika 1, gërma a; neni 65; neni 68; Statutin e UT neni 29; neni 30; neni 31; neni 32; neni 75; neni 76; neni 77; rregulloren “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në UT” neni 5, neni 6; Urdhërat nr.8 datë 14.01.2020, nr.99 datë 26.03.2020, nr.108 datë 08.05.2020 “Për procesin zgjedhor për autoritetet dhe organet drejtuese në institucionet publike të arsimit të lartë” të Ministri të MASR, Kodin e Procedurave Administrative neni 108; neni 109; neni 110; neni 111; si dhe në propozimet e anëtarëve të Senatit në mbledhjen e datës 21.05. 2020, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës;

VENDOSI:

1.Të konstatojë pavleshmërinë absolute të vendimeve të Rektorit të UT për zgjidhjen në mënyrë të menjëhershme, të kontratave të punës për personelin akademik me kohë të plotë Zj.Majlinda Keta, Z.Bernard Dosti, Zj.Oriona Mucollari, Z.Ardian Doka e Zj.Eglantina Gishti dhe vazhdimin e marrëdhënieve të punës së tyre me Universitetin e Tiranës në Njësitë Kryesore përkatëse.

Referimi tek Kodi i Punës nuk ka relevancë ligjore për punësimin dhe ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për personelin akademik i cili rregullohet nga Ligji për Arsimin e Lartë dhe Statuti i UT.

2.Për shkak se procesi zgjedhor në UT ka filluar, zgjedhja e KIZ të ri do të bëhet mbas përfundimit të këtij procesi për Autoritetet Drejtuese dhe Organin Drejtues në Universitetin e Tiranës.

3.Ky vendim i përcillet për zbatim Rektorit, Drejtuesve të Njësive Kryesore, KIZ dhe KZF të Fakulteteve, si dhe u njoftohet personelit akademik, Bordit të Administrimit dhe Administratorit të Universitetit të Tiranës.

4.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

PËR SENATIN AKADEMIK TË UT

ZV/ KRYETARJA

Prof.Asoc.Dr. Eliona KULLURI

